



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:003404

Datë: 27.10.2022

Numri i dokumentit: 03574429

C.nr.4/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, me bashkëpunëtorin profesional Afrim Gashi, në çështjen juridike të paditësit T. C., nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson av. D. H. nga Prizreni, me autorizim si në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "E." me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit **1.000 €uro**, me datë **27.10.2022** merr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësit T. C., nga Rahoveci, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR.**

A r s y e t i m

Paditësi T. C. nga Rahoveci, të cilin e përfaqëson avokati D. M., nga Prizreni, me autorizim si në shkresat e lëndës, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "E." me seli në Prishtinë, me bazë juridike - kompensim i dëmit.

Gjykata me aktvendim C.nr.4/2022 të datës 04.07.2022 e ka ftuar paditësin që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ta paguaj taksën gjyqësore në shumën prej katërdhjetë 40.00 Euro, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguan do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se i autorizuari i paditësit me datë 27.04.2022 e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës së kërkuar për padinë.

Sipas nenit 253 par. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e taksës për padi brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim të tij nga pagesa e të njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 253.5 lidhur me nenin 387.1 pika c) të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA RAHOVEC,
C.nr.4/2022, me datë 27.10.2022.**

**B. Profesional
Afrim Gashi**

**GJYKATËSI
Besmir Juniku**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.